



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 598/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Loti 1, Blerje goma për automjete*”, me nr. REF-75114-10-13-2020, me fond limit 62,458,286 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k.
Adresa: “*Rruga e Kavajës*”, P.29, Kulla B, Ap.36, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Sheshi “*Skënderbej*”, nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.10.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Loti 1, Blerje goma për automjete*”, me nr. REF-75114-10-13-2020, me fond limit 62,458,286 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 06.11.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 26.11.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--------------------------------|--------------------------------|
| 1. “Klosi – R Company” sh.p.k. | 35,246,332 lekë, Kualifikuar; |
| 2. “Gajd Company” sh.p.k. | 39,756,000 lekë, Skualifikuar; |
| 3. “R & R Group” sh.p.k. | 40,052,650 lekë, Kualifikuar; |
| 4. “Varvara” sh.p.k. | 59,112,990 lekë, Skualifikuar |

II.4. Në datën 26.11.2020, operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë:

“• *Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 3, gërma, e, pasi nuk arriti të paraqesë Certifikatë për transport mallrash në emër të vet. Në SPE si pjesë të ofertës së tij është paraqitur dokumenti i emërtuar “7.GAJD_Mjet_me_Qira_AA875AU+_AA640RJ”, sipas kontratës së qiras nr. 1968 Rep, me datë 03.09.2020 si dhe kontratës së qiras nr. 2777 Rep, me datë 05.11.2020, konkretisht përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve me targë AA875AU dhe AA640RJ, të cilat i disponon shoqëria “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK, sipas lejeve të qarkullimit*

janë specifike dhe të lëshuar për kryerjen e transportit të mallrave, brenda vendit, vetëm për llogari të veprimtarisë së kësaj shoqërie. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e operatorit ekonomik “GAJD Company” SHPK me kamionat e shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.”

II.5. Në datën 01.12.2020, operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresës nr. 2380/3 prot, datë 02.12.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., duke e refuzuar atë.

II.7. Në datën 09.12.2020, operatori ekonomik ankimues “Gajd Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Shoqeria jone e kundërshton arsyen e skualifikimit nga Autoriteti Kontraktor si të pabazuar në ligjin për prokurimin publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, DST e tenderit piken 3 germa e) seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik si edhe ligjin specifik që ju keni përmendur në arsyet e skualifikimit në ligjin nr.9308 datë 18.03.1998 Për transportet rrugor i ndryshuar. Shoqeria jone në lidhje me përbushjen e kriterit të vendosur në DST e tenderit piken 3 germa e) sekstori 2.3 Kapaciteti Teknik ka paraqitur dy automjete të marra me qira nga shoqeria ERAL, në të cilën kontrata e qirase është përpiluar sipas formës së duhur dhe të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë së bashku me dokumentacionin shoqerues ku ndër to është dhe Certifikata për transportin e mallrave, respektivisht nr.32 datë 19.05.2020 dhe nr.4 datë 20.01.2020 të lëshuara nga njësia vendore Bashkia Tepelene të cilat janë brenda afatit të miratuar.

Në Nenin 41 të ligjit nr.9308 datë 18.03.1998 Për transportin rrugor i ndryshuar Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Pra këtu përcaktohet qartë që është i ndaluar të kryhet transporti i mallrave pa licencën përkatëse, ndërkohë që në rastin tonë mjetet e transportit të marra me qira janë të pajisura me Certifikatën përkatëse të transportit. Automjeti duke qenë në pronësi të Shoqërisë Eral Construction Company Shpk (qeradhënsi) mban dhe lejen e transportit të po kësaj shoqërie sepse shoqëria Gajd Company Shpk është përdoruese dhe jo pronare e këtij Automjeti. Në këtë rast Operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë qiraje (përdoruese) dhe jo një kontratë blerjeje që të kalojë dokumentat në emër të tij. Pra ligji i mesipër është keqinterpretuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Shoqëria jone e ka përbushur kriterin e përcaktuar në DST si vijon:

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

a) Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit:

c) *Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore:*

d) *Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve:*

e) *Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton):*

f) *Leje drejtimi automjeti, për të paktën 1 (një) prej punonjësve.*

Bashkëngjitur po ju dergojme edhe certifikatat perkatese.

Ne lidhje me kriterin s'kualifikues qe Autoriteti juaj Pretendon, Shoqeria jone ka marre pjese ne te njejten procedure prokurimi te zhvilluar nga Autoriteti juaj ne daten 23.05.2019 me objekt " Blerje Goma per automjete" , Ku ka paraqitur Autojmetin me Qera me targe AA292KD te marre me qera nga e njejta shoqeri " Eral Construction Company" dhe ka paraqitur lejen e transporti te automjetit ne emer te shoqerise Qeradhenese "Eral Construction Company" Shpk. Ne kete procedure tenderimi Shoqeria jone eshte kualifikuar me te njejtat dokumenta qe autoriteti kontraktor e s'kualifikon.

Per sa me larte ky kualifikim na jep te drejte te gjykojmë se është bere i njeanshme për te gjetur argument skualifikimi te shoqerise tone. Per sa me siper kerkojme vleresimin e ofertes tone te vlefshme pasi i ka permbushur kriteret e DST sipas nenit 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...". Oferta eshte ne perputhje me ligjin, rregulloren per prokurimin publik ligjin nr.9308 date 18.03.1998 Per transportin rrugor i ndryshuar dhe kriteret e vendosura ne DST. [...]"

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2467/1 prot., datë 17.12.2020, protokolluar me tonën në datën 22.12.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Gajd Company" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 26.11.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Klosi – R Company” sh.p.k.	35,246,332 lekë, Kualifikuar;
2. “Gajd Company” sh.p.k.	39,756,000 lekë, Skualifikuar;
3. “R & R Group” sh.p.k.	40,052,650 lekë, Kualifikuar;
4. “Varvara” sh.p.k.	59,112,990 lekë, Skualifikuar

III.1.2. Në datën 01.12.2020, operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.3. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresës nr. 2380/3 prot, datë 02.12.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Gajd Company” sh.p.k., duke e refuzuar atë.

III.1.4. Në datën 09.12.2020, operatori ekonomik ankimues “Gajd Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.5. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se, është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP-së. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial* i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP.

III.1.7. Komisioni thekson se, i vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP, nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Gajd Company” sh.p.k., konstaton se ky i fundit, ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke ngritur pretendime, vetëm mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, ndërkohë që, referuar klasifikimit të ofertave të datës 26.11.2020 në SPE, rezulton se, operatori ekonomik “Klosi – R Company” sh.p.k. është i kualifikuar dhe i renditur me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që operatori ekonomik ankimues “Gajd Company” sh.p.k. në ankesën pranë KPP ka ngritur pretendime vetëm mbi skualifikimin e ofertës së tij dhe në asnjë rast nuk ka kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Klosi – R Company” sh.p.k., i cili rezulton i kualifikuar dhe me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimues, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar me ofertë më të ulët ekonomike.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Gajd Company” sh.p.k. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Loti 1, Blerje goma për automjete”, me nr. REF-75114-10-13-2020, me fond limit 62,458,286 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijoje me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1655 Protokoli Datë 09.12.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri